

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kishte vjedhur një automjet, gjatë arratisjes goditi 4 makina! Vihet në pranga 30-vjeçari në Durrës (VIDEO) - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/kishte-vjedhur-nje-automjet-gjate-arratisjes-goditi-4-automjete-vihet-ne-pranga-30-vjecari-ne-durres/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:30:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:25:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9ea1eda599bb8300b3bbbe3e6b8c5350b1bb962eb531a028c6da314e0f316f83
TEKSTI	ef7ecbdb09e2c5d93b88fe4bb51c027b5d9dfac2c3a40e7e583d370d6352d61
PAMJA	07a6e6566e3f64d9c704d34e45e30af59761b2671935c7e7894b2242bde7dedb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	abe0d74d43bb60d68b0b5052b9d8a62bb96593670c061cccd92af5f7b402c3da
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/abe0d74d43bb60d68b0b5052b9d8a62bb96593670c061cccd92af5f7b402c3da>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Donald Trump Edi Rama Inteligjenca Artificiale Gjyqi i UÇK

AKTUALITET | VENDI

Kishte vjedhur një automjet, gjatë arratisjes goditi 4 makina! Vihet në pranga 30-vjeçari në Durrës (VIDEO)

26 Shtator 2026 | 10:25

Një 30-vjeçar është vënë në pranga nga policia në Durrës. Arrestimi i tij mësohet se ka ardhur pasi ai ka vjedhur një automjet. Sipas njoftimit, autori ka tentuar t'i arratiset policisë dhe është përplasur me 4 makina të tjera.

Ai rezultoi se ishte person i shpallur në kërkim për veprën penale "Vjedhja", pasi një ditë më parë kishte vjedhur në Tepelenë automjetin me të cilin tentoi t'i largohej policisë.

Pas kësaj ngjarjeje, atij iu shtuan akuzat. Ai akuzohet edhe për veprat penale "Mosbindja e urdhrit të punonjësit të rendit publik", "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt".

"Durrës/ Kishte vjedhur një automjet dhe, për t'i shpëtuar policisë, goditi 4 automjete, duke rrezikuar jetën e qytetarëve dhe të punonjësve të Stacionit të Policisë Plazh, neutralizohet dhe vihet në pranga 30-vjeçari.

Shërbimet e Stacionit të Policisë Plazh Durrës, gjatë patrullimit në territor, në rrugën "Pavarësia", rreth orës 23:00, kanë konstatuar një automjet pa targa dhe me xhama të zinj, që kryente manovra të rrezikshme në rrugë, dhe janë vënë në ndjekje të tij.

Drejtuesi i automjetit, sapo vuri re prezencën e policisë, shtoi shpejtësinë dhe tentoi t'u largohej shërbimeve, të cilët i bënë shenjë ndalimi. Në ikje e sipër, drejtuesi i automjetit aksidentoi 4 automjete, duke rrezikuar jetën e qytetarëve dhe të punonjësve të policisë, dhe më pas braktisi automjetin, duke tentuar të largohej me vrap, por u neutralizua nga shërbimet e policisë.

Nga verifikimet paraprake rezultoi se personi i ndaluar, shtetasi M. K., 30 vjeç, ishte person i shpallur në kërkim për veprën penale "Vjedhja", pasi një ditë më parë kishte vjedhur në Tepelenë automjetin me të cilin tentoi t'i largohej policisë.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore të kryera nga ana e Specialistëve të Hetimit, u bë arrestimi në flagrancë i 30-vjeçarit, për veprat penale "Vjedhja", "Mosbindja e urdhrit të punonjësit të rendit publik", "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" dhe "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt". Materialet i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme", njofton policia.

LAJMI I FUNDIT

10:25 **Kaos me pasoja serioze, agjentët e OpenAI dalin jashtë kontrollit! Implikohen faqet e qeverisë amerikane**

10:19 **Putin përmbys çdo pretendim: Ne nuk do të bëjmë luftë me Europën**

10:10 **Michael Olise barazon rekordin 68-vjeçar, 9 asistime me Francën në një vit**

SHPËRNDAJE
ARTIKULLI Shtëpia e Bardhë bllokon CNN të udhëtojë me Air Force One

09:59 **Trump anulon gati 1 miliard dollarë fonde të miratuara nga Kongresi**

09:40 **Arrestohet në Rinas 53-vjeçari ukrainas, ishte shpallur në kërkim për trafik droge**

TESTIM



Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Arrestohet në Rinas 53-vjeçari ukrainas, ishte shpallur në kërkim për trafik droge

Një 53-vjeçar ukrainas është arrestuar në aeroportin e Rinasit, pasi rezultonte i shpallur në kërkim nga autoritetet e Kievit për trafik të lëndëve narkotike, në...

09:40 | 26/09/2026

AKTUALITET | SPORT | VENDI

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia plan masash: Ja rrugët që do të kufizohet qarkullimi

Policia e Shtetit ka dalë këtë të shtunë me një plan masash për garantimin e rendit dhe sigurisë në kuadër të ndeshjes Shqipëri-Bjellorusi e cila...

09:08 | 26/09/2026

AKTUALITET | REVIEW | VENDI | VIDEO

"A kishte dijeni Vlora Hyseni për vendndodhjen e Agasit?" Gazetari Koka: SPAK thotë se e dinte

Gazetari, Spartak Koka i ftuar këtë të premte në emisionin "Review" me Greta Topjana në Euronews Albania ka folur lidhur me çështjen e ish-drejtoreshës së shërbimit...

22:18 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.